

## UDHËZUES PËR APLIKIM

Procesi i aplikimit i jep mundësi ofruesve publikë dhe jopublikë të shërbimeve të kujdesit shoqëror të bëhen pjesë e Konkursit Kombëtar të Praktikave të Mira, që ndërmerret në zbatim të projektit “Praktikat më të mira në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” që po zbatohet nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim me mbështetjen e UNDP si pjesë e programit “Askush Të Mos Mbetet Pas”.

## DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

1. Formulari i Aplikimit i cili shërben për shprehjen e interesit
2. Letër reference nga një prej institucioneve: Bashki, Këshill Qarku, Shërbimi Social Shtetëror<sup>1</sup> - Në rast se shërbimi ofrohet nga ofrues jopublikë.

### 1. Formulari për shprehjen e interesit

Formulari i Aplikimit është i organizuar në tre pjesë:

#### ***Pjesa e parë: Të dhëna për shërbimin***

Aplikanti duhet të plotësojë të dhënat thelbësore për shërbimin (tipi i shërbimit, vendndodhja e shërbimit, përfituesit, financimi, personeli, përshkrim i shërbimit).

#### ***Pjesa e dytë: Shërbimi si pjesë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror***

**Konteksti:** duhet të lexohet nga aplikanti në mënyrë që të ketë një pamje të qartë mbi politikat dhe legjislacionin kombëtar në lidhje me sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror prej nga janë identifikuar kriteret ku do të bazohet vlerësimi i çdo shërbimi.  
**Aplikimi:** Aplikanti do të japë përgjigje 9 pyetjeve të cilat synojnë të identifikojnë se sa dhe si shërbimi për të cilin aplikohet është pjesë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

#### ***Pjesa e tretë: Cilësia dhe përshtatshmëria e shërbimit***

**Konteksti:** Prezanton parimet mbi të cilat duhet të administrohen shërbimet e kujdesit shoqëror në përputhje me legjislacionin kombëtar. Konteksti duhet të lexohet nga aplikanti për të kuptuar qartësisht se si janë identifikuar kriteret që do të jenë bazë për vlerësimin e çdo shërbimi.

<sup>1</sup> Ne varësi me nivelin ku është ngritur shërbimi: komunitar, rajonal, kombëtar

**Aplikimi:** Aplikanti do t'i japë përgjigje 13 pyetjeve të cilat në thelb synojnë të identifikojnë se sa dhe si shërbimi për të cilin aplikohet përmbush kriteret e cilësisë dhe përshtatshmërisë sipas kriterëve që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar.

Në plotësimin e pjesëve “aplikimi” mbani në konsideratë që në pyetjet me alternativë ka raste që mund të plotësoni më shumë se një alternativë. Në pyetjet e hapura jepni thelbin, pa tejkalar hapësirën e përcaktuar për përgjigje.

## 2. Letër reference nga një prej institucioneve: Bashki, Këshill Qarku, Shërbimi Social Shtetëror<sup>2</sup> - Në rast se shërbimi ofrohet nga ofrues jopublik<sup>3</sup>

Ofruesi jo publik mund të marrë letrën e referencës nga një prej tre institucioneve: Bashki/Këshill Qarku/Shërbim Social Shtetëror, kjo në varësi të ndërveprimit që ka me institucionet përkatëse në praktikën e punës. Nëse shërbimi është ngritur dhe funksionon në nivel komunitar letra e referencës do të merret nga Bashkia. Nëse shërbimi është ngritur dhe funksionon në nivel qarku dhe/ose kombëtar ofruesi i shërbimit mund të marrë letër reference nga Këshilli i Qarkut ose Shërbimi Social Shtetëror.

Letra e referencës duhet të shpjegojë sa dhe si ofruesi i shërbimit ndërvepron me strukturën e shërbimit social të Bashkisë/Qarkut/Shërbimit Social Shtetëror. Ndërveprimi mund të ketë forma të ndryshme:

- Shërbimi i ngritur adreson një/disa nga nevojat për shërbime të identifikuara në Planin Social Lokal, dhe/ose;
- Shërbimi i ngritur adreson një/disa nga prioritetet e politikave lokale të njësisë vendore dhe/ose;

<sup>2</sup> Kjo në përputhje me nivelin ku është ngritur shërbimi: komunitar, rajonal, kombëtar

<sup>3</sup> Në përputhje me nenin 9 të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, “Klasifikimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror”:

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.

- a. Në **shërbimet shoqërore publike** përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore .
- b. **Shërbimet jopublike** klasifikohen në shërbime fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Shërbimet shoqërore fitimprurëse nuk mund të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe ai i bashkive. Shërbimet shoqërore jofitimprurëse gëzojnë të drejtën të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit apo ai i bashkive, vetëm nëse kanë lidhur kontratë me subjektin që ka përgjegjësi për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror.

- Përfituesit e shërbimit bëhen pjesë e shërbimit mbi bazën e vlerësimit fillestar të kryer nga strukturat e njësisë vendore përgjegjëse për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve sociale dhe/ose;
- Për çdo përfitues që merr shërbim ka një vendim të Këshillit të Bashkisë/Këshillit të Qarkut/Shërbimit Social Shtetëror për ofrimin e shërbimit dhe/ose;
- Punonjësit e shërbimit ndërveprojnë me punonjësin e njësisë vendore përgjegjës për menaxhimin e rastit përgjatë zbatimit të planit individual në kohën e marrjes së shërbimit dhe kur marrja e shërbimit për individin përfundon.